EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5730
E mërkurë, 20 mars 2019
çmimi 0.40 €

Kosnetti bën thirrje për transparencë dhe llogaridhënie, kërkon të zbatohet ligji

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME, IZMI ZEKA

FAQE 4-5

Legalizimi i armëve e bën Kosovën vend më të sigurt

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh Koordinator Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka, ka bërë me dije se legalizimi i armëve e bën Kosovën vend më të sigurt për të jetuar.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka kërkuar mbështetjen e krerëve të shtetit dhe të gjithë qytetarëve në këtë proces. Sipas Zekës, me këtë proces Kosova po e merr përgjegjësinë rajonale dhe ndërkombëtare që i takon në këtë fushë. Zëvendësministri Zeka ka treguar se deri më tani janë pranuar 539 kërkesa për legalizim të armëve, kurse nga këto janë dhënë 246 pëlqime

HARADINAJ THOTË SE POLITIKA ËSHTË FAJTORE PËR IKJEN E QYTETARËVE NGA KOSOVA

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar faktin se politika është fajtore për largimin e qytetarëve nga vendi. Ndërkaq duke u përgjigjur për punësimet e fundit nga partia që drejton, AAK-ja, ai ka thënë se punësimet në Kosovë po bëhen nga të gjitha partitë politike. Haradinaj ka thënë se AAK-ja as një për qind nuk është e përfaqësuar në institucione. Sipas tij, nuk është mirë të shesin moral ata që e kanë sjellë gjendjen deri këtu. Këto komente kryeministri Haradinaj i ka bërë të martën në një konferencë për medie pas mbledhjes së kabinetit qeveritar

FAQE 3

Ambasadorët e BE-së informohen për zhvillimet në sundimin e ligjit

AKTUALE

TAKSA 100 PËR QIND DHE LULET E XHENETIT

F. 11

Jakup KRASNIQI

LDK-ja KËRKON DEBAT PARLAMENTAR PËR AKSIDENTET NË KOMUNIKACION

F. 7

FATMIR LIMAJ VIZITON KOMPLEKSIN MEMORIAL NË ÇANAKALA

F. 7

EKONOMI

ASK-ja: NIVELI I PAPUNËSISË, 31.4 PËR QIND

F. 8

KAPET NJË SASI E KONSIDERUESHME E MEDIKAMENTEVE GJATË TENTIMKONTRABANDIMIT

F. 9

KULTURË

MINISTRI GASHI: 'LIBRI I LUFTËS', PROJEKT HISTORIK

F. 6

SPORT

SEJDIU: KOSOVA DUHET TË LUAJË PËR FITORE NDAJ DANIMARKËS DHE BULLGARISË

F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Dorëzohet në KShZ kandidatura për president e Blerim Rekës

Shkup, 19 mars - Përfaqësues të Shtabit Zgjedhor të kandidatit për president, Blerim Reka, dorëzuan në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KShZ) kandidaturën e Rekës për zgjedhjet presidenciale. Në afat prej 48 orësh KShZ do ta kontrollojë të gjithë dokumentacionin dhe do ta konfirmojë Rekën si një nga tre kandidatët për këto zgjedhje. Shefi i Shtabit zgjedhor të Blerim Rekës, Florin Asani, tha se fushata zgjedhore nuk do të ketë në fokus vetëm shqiptarët, por të gjithë qytetarët e Maqedonisë. "Koncepti i profesor Blerim Rekës e bën atë të veçantë nga kandidatët e tjerë. Ne preferojmë që ai vetë ta prezantojë programin e vej. Do të kemi një fushatë pak më ndryshe, do të kemi një koncept të ri", tha Florin Asani, shef i Shtabit Zgjedhor të Blerim Rekës.

Kosnetti bën thirrje për transparencë dhe llogaridhënie, kërkon të zbatohet ligji

Të martën e ka filluar zyrtarisht punën Njësiti për Luftimin e Mashtrimit, i cili do të veprojë në kuadër të Departamentit për Çështje Ligjore të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Me këtë rast, ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka bërë thirrje për transparencë dhe llogaridhënie, duke kërkuar nga institucionet e Kosovës që ta zbatojnë ligjin

Prishtinë, 19 mars (ER) - Në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës do të funksionojë edhe një njësit i ri. Njësiti për Luftimin e Mashtrimeve të martën ka bërë nisjen zyrtare të punës ku ka marrë pjesë edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett.

Konsnett ka pohuar se kjo është një gjë e mirë që po fillon në Kosovë. Ai ka përmendur disa raste ku është shënuar sukses, por për disa raste ka thënë se institucionet nuk e kanë kryer punën e tyre. "Më duhet të them se jam i lumtur për fillimin zyrtar të Njësitit për Luftimin e Mashtrimit brenda zyrës së Auditimit. Ky është shembull se si drejtësia dhe parimi ndërthuren. Dua të filloj duke shënuar të arriturat. Në viti 2016 komuna e Leposaviqit kishin paguar dy herë për riparimin e rrugës ndërsa Zyra e Auditimit reagoi menjëherë duke i kthyer 86 mijë euro nga kontraktuesit. Përkundër këtij dhe suksese tjera shumë institucione nuk po e bëjnë punën e tyre, vetëm 1/3 janë

trajtuar gjatë viteve të fundit", ka deklaruar Kosnett.

Ambasadori amerikan ka thënë se ka ardhur koha që institucionet të zbatojnë ligjin, të tregojnë transparencë dhe llogaridhënie. "Edhe Kuvendi që mbikëqyr Zyrën e Auditimit është bashkëfajtor në këtë shpërfillje. Me themelimin e Zyrës kundër mashtrimit tregon se s'do të zmbrapset, edhe pse sot po e fillojmë zyrtarisht, njësiti është aktiv para tre muajve. 38 raste të mashtrimit janë raportuar bazuar në vitin 2017. Ky është vit premtues që t'u dëshmojnë institucioneve që s'kanë asgjë për të fshehur. Kosovarët meritojnë të kenë përfaqësues që tregojnë transparencën dhe llogaridhënien. Ka ardhur koha që institucionet të marrin përgjegjësi për zbatimin e ligjit. I bëj thirrje Policisë dhe zyrës së Prokurorit për të ndihmuar Zyrën e Auditimit në zbatimin e ligjit. Ju bëjë thirrje qytetarëve dhe shoqërisë civile që të angazhohen dhe të sigurohen që korrupsioni nuk ka vend ku të fshihet", ka thënë Kosnett.

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës ka marrë mbështetje të vazhdueshme nga USAID-i për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale për trajtimin e mashtrimit të hasur gjatë procesit të auditimit si dhe për themelimin e Njësitit për Luftimin e Mashtrimit. Deri tani për këtë qëllim janë trajnuar rreth 60 auditorë.

Rusia do të njohë emrin e ri të Maqedonisë së Veriut

Shkup, 19 mars - Federata Ruse njoftoi se do ta njohë emrin e ri të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konfirmoi ambasadori rus në Shkup, Sergej Bazdnikin, i cili i dorëzoi të martën kryeministrit maqedonas Zoran Zaev një notë të Ministrisë së Jashtme të Rusisë me këtë vendim.

Më parë Moska nuk kishte dhënë shenja për njohjen e Marrëveshjes së Prespës midis qeverive të Greqisë dhe të Maqedonisë së Veriut për emrin. Zyrtarë rusë kishin lënë të kuptohet se do ta bllokonin vendimin në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, madje nga Moska vinin kërcënime se Maqedonia e Veriut, duke u bërë pjesë e NATO-s, mund të ishte objekt i sulmeve të raketave ruse.

Qëndrimi i ri rus i shton shpresat se Moska do t'i përmirësojë marrëdhëniet miqësore dhe ekonomike me vendin e vogël ballkanik. Një komision i përbashkët ndërqeveritar për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik do të mblidhet në një të ardhme të afërt. Maqedonia e Veriut eksporton në Rusi kryesisht fruta dhe perime.

Analistët në Shkup mendojnë se Moskës i duhej edhe një vend mik në Ballkan dhe se ajo pretendon të shtrijë një politikë paqësore këtu.

Kryemadhi: Mandatet në Shkodër janë marrë me gjak

Tiranë, 19 mars - Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, nga qyteti i Shkodrës foli për motivin e largimit të shqiptarëve nga vendi, duke thënë se fajin e ka qeveria. "Ndihemi të mërzitur për mënyrën se si qeveria drejton në mënyrë të pabarabartë sistemin. Nuk mund të vazhdojë kjo qeveri, që zgjat agoninë e shqiptarëve. Po mbajmë vendin e parë në Evropë për azilkërkuesit. Fëmijët e shqiptarëve duan të ikin nga Shqipëria dhe nuk duan të kthehen më. Kjo është fatkeqësia më e madhe. Kjo do të jetë një mallkim për klasën politike. Ka ardhur koha që t'i japim fund stabilitetit të krimit të organizuar", tha ajo. "Djegia e mandateve tona ishte një vendim ekstrem. Ua dhamë idenë njerëzve se ne nuk mendojmë për veten tonë. Di të them se mungesa e shtetit e detyroi opozitën shqiptare për t'i djegur mandatet. E dimë shumë mirë se marrja e mandatit në Shkodër është mandat gjaku. Jo vetëm në Shkodër, por kudo", tha Kryemadhi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj thotë se politika është fajtore për ikjen e qytetarëve nga Kosova

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pranuar faktin se politika është fajtore për largimin e qytetarëve nga vendi. Ndërkaq duke u përgjigjur për punësimet e fundit nga partia që drejton, AAK-ja, ai ka thënë se punësimet në Kosovë po bëhen nga të gjitha partitë politike. Haradinaj ka thënë se AAK-ja as një për qind nuk është e përfaqësuar në institucione. Sipas tij, nuk është mirë të shesin moral ata që e kanë sjellë gjendjen deri këtu. Këto komente kryeministri Haradinaj i ka bërë të martën në një konferencë për medie pas mbledhjes së kabinetit qeveritar

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 19 mars - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se ai dhe politika janë fajtorë për ikjen e qytetarëve nga vendi. Ai ka pranuar faktin se punësimet në Kosovë bëhen nga të gjitha partitë politike. "Politika i ka fajet, po edhe unë që qytetarët po ikin nga vendi. Të gjithë, PDK-ja, LDK-ja, Vetëvendosja, edhe AAK-ja, kushdo që ka pasur përgjegjësi, ka faj. Por mënyra për ta ndryshuar këtë është duke qenë të sinqertë dhe duke u përballur me gjendjen", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë për medie të mbajtur pas mbledhjes së Qeverisë.

Pavarësisht prej punësimeve të fundit, ai ka thënë se AAK-ja as një për qind nuk është e përfaqësuar në institucione. Madje, sipas Haradinajt, njerëzit më të diskriminuar kanë qenë të Aleancës. "Jam kundër këtyre abuzimeve edhe prej familjarëve të mi, edhe prej Aleancës, por njerëzit më të diskriminuar kanë qenë njerëzit e AAK-së", ka theksuar ai, duke shtuar se nuk duhet të shesin moral ata që e kanë sjellë gjendjen deri këtu. "Veç nuk është mirë me na shitë moral këta të tjerët që e kanë sjellë gjendjen deri këtu", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Shefi i Qeverisë ka falënderuar Ambasadën e Britanisë së Madhe në Kosovë për programin për rekrutim në sektorin publik sepse, sipas Haradinajt, pa këtë program gjendja do të ishte edhe më e keqe. "Është mirë që ekziston ai program sepse pa të gjendja do të ishte më e keqe. Është risi punësimi i disa të afërmve qoftë me mua, qoftë me AAK-në. AAK-ja ka një besim rreth 10 për qind të popullit të Kosovës në zgjedhjet që shkuan. Në institucione as një për qind nuk përfaqësojmë. As në kompani publike dhe askund. E mirëpres kritikën e ambasadorit O'Connell. E meritojmë të na jepet ajo kritikë. Jam kundër abuzimeve qofshin familjarë, qofshin të AAK-së. Njerëzit më të diskriminuar në sektorin publik janë të AAK-së", ka theksuar ai.

Në këtë konferencë me gazetarë kryeministri Haradinaj ka folur edhe për dialogun me Serbinë duke thënë se Kosova pret ndihmën e të gjitha palëve që të vazhdojë ky proces por, sipas tij, dialogu nuk duhet të ndërlidhet me taksën. "Taksa dhe dialogu janë tema të kaluara, duhet të shohim nga e ardhmja. Kosova pret ndihmën e të gjitha palëve që të vazhdojë dialogu, por ky proces mos të ndërlidhet me vendimin e qeverisë për tarifën", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri ka folur edhe për aksidentet në trafik, me ç'rast ka thënë se ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme t'i analizojë shkaqet që kanë çuar në ngritjen e numrit të aksidenteve tragjike në rrugët e Kosovës, si dhe ka rekomanduar masa për parandalimin e këtyre aksidenteve.

Gjithashtu, kryeministri ka kërkuar sqarime për zbatimin e marrëveshjeve me Republikën e Shqipërisë në fushën e kalimeve kufitare pasi, sipas tij, janë vërejtur sërish kolona dhe pritje në këtë kufi.

Qeveria miraton programin kombëtar për zbatimin e MSA-së 2019-2023

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka miratuar masat për t'i adresuar veprimet që dalin nga Raporti për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2018 të publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Qeveria ka kërkuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse për ta përmirësuar situatën e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Kabineti qeveritar ka obliguar resorët përkatës që në periudha kohore prej 90 ditësh të përgatisin raporte për realizimin e masave të përmirësimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës. Po ashtu, Qeveria ka miratuar edhe programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2019-2023.

Për zbatimin e këtij vendimi janë të obliguara Zyra e Kryeministrit, Ministria e Integrimeve Evropiane dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Programi për zbatimin e MSA-së do të procedohet për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për shpronësimin për interes publik të ndërtesës së ish-"Gërmia", sipas së cilës, Qeveria e Kosovës ka marrë obligimin e pagesës së shumës totale të shpronësimit dhe të vlerave të kërkesave eventuale nga kreditorët.

Në mbledhjen e së martës është aprovuar edhe nisma për negocimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës për bashkëfinancim të granteve të komunave sipas performancës së tyre. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për përkthimin e infrastrukturës ligjore për personat e verbër në alfabetin e brailit.

Fëmijët e Kosovës operohen nga kardiokirurgët italianë

Prishtinë, 19 mars (ER) - Kardiokirurgë nga Italia po qëndrojnë këto ditë në Prishtinë dhe, bashkë me kardiokirurgë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, po operojnë fëmijët me probleme në zemër. Kardiokirurgu në Klinikën e Kardiokirurgjisë, dr. Arbër Kutllovci, e vlerësoi lart bashkëpunimin me mjekët italianë. Kutllovci ka thënë se me ndihmën e tyre në QKUK po kryhen operacione komplekse. Sipas tij, të gjithë pacientët e operuar janë liruar në shtëpi, me gjendje të mirë shëndetësore, pavarësisht se ishin raste komplekse.

Në anën tjetër, kardiokirurgu italian Bruno Murzi është shprehur i kënaqur me bashkëpunimin me mjekët nga Kosova. Ai ka thënë se mjekët në Kosovë po bëjnë një

punë të mirë, derisa foli edhe për operacionet të cilat janë paraparë të kryhen deri në ditën e premte. Një ekip i mjekëve nga Italia, i udhëhequr nga dr. Carlo Barzaghi dhe dr. Maurizio Levantino, nga Spitali i Toskanas në Itali, të asistuar nga mjekët kardiokirurgë nga Kosova, javën e kaluar kanë kryer disa operacione në QKUK tek pacientët e moshës së rritur me probleme kardiokirurgjike.

Flet për "Epokën e re" zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka

Legalizimi i armëve e bën Kosovën ve

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh edhe Koordinator Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka, ka bërë me dije se legalizimi i armëve e bën Kosovën vend më të sigurt për të jetuar. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka kërkuar mbështetjen e krerëve të shtetit dhe të gjithë qytetarëve në këtë proces. Sipas Zekës, me këtë proces Kosova po e merr përgjegjësinë rajonale dhe ndërkombëtare që i takon në këtë fushë. Zëvendësministri Zeka ka treguar se deri më tani janë pranuar 539 kërkesa për legalizim të armëve, kurse nga këto janë dhënë 246 pëlqime

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 MARS - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, njëherësh edhe Koordinator Nacional për Armë të Vogla dhe të Lehta, Izmi Zeka, ka deklaruar se me legalizimin e armëve Republika e Kosovës do të bëhet vend më i sigurt. Ai ka treguar se me këtë proces Kosova po e merr përgjegjësinë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar që i takon në këtë fushë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zeka ka kërkuar mbështetjen e krerëve të shtetit dhe të gjithë qytetarët në këtë proces. "Kosova është një vend më i sigurt për të jetuar, përderisa më shumë armë janë nën kontroll dhe Kosova merr përgjegjësinë e saj në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e kontrollit të AVL-ve dhe kontribuon në një rajon më të sigurt", ka thënë Zeka.

Ai ka sqaruar se legalizimi është një proces i zbatuar në vende të ndryshme në rajon. Sipas tij, ky proces çon në një reduktim të posedimit të paligjshëm të armëve. "Keqpërdorimi i armëve dhe trafiku i tyre i paligjshëm nuk janë shqetësim vetëm për sigurinë publike në Kosovë, por edhe për rajonin, duke qenë se nxisin krimin e organizuar dhe terrorizmin, ndërkohë që siguria jonë është e lidhur ngushtë me sigurinë dhe stabilitetin e Bashkimit Evropian. Kjo është hera e parë që institucionet e Kosovës e kanë lansuar vetë këtë proces dhe deri më tash kemi parë interes të madh, por kërkohet edhe mbështetja juaj për promovimin e legalizimit të armëve, në mënyrë që përpjekjet tona të jenë vërtet të suksesshme dhe të sigurohet interesi ynë i përbashkët për një Kosovë më të sigurt", ka thënë Zeka. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për procedurën e cila duhet të ndiqet nga qytetarët që dëshirojnë ta legalizojnë armën e tyre.

Zeka ka treguar se deri më tani ka mbi 500 kërkesa për legalizim të armëve. "Deri më sot janë pranuar 539 kërkesa për legalizim dhe nga këto janë dhënë 246 pëlqime. Kërkesat e tjera janë ende në procedurë. Procesi i legalizimit është dizajnuar si i tillë që të ndikojë në uljen e këtij numri të armëve të vogla dhe të lehta", është shprehur zëvendës-ministri i Punëve të Brendshme.

"Epoka e re": *Z. Zeka, të hënën u jeni drejtuar me një letër drejtuesve të shtetit sa i përket procesit të legalizimit të armëve. Cili ishte qëllimi i kësaj letre?*

Zeka: Qëllimi i kësaj letre të hapur është të kërkojë mbështetje nga krerët e shtetit dhe të gjithë qytetarët e tjerë për ta bërë Kosovën një vend më të sigurt për të jetuar. Legalizimi është një proces i zbatuar në vende të ndryshme në rajon që çon në një reduktim të posedimit të paligjshëm të armëve. Keqpërdorimi i armëve dhe trafiku i tyre i paligjshëm nuk janë shqetësim vetëm për sigurinë publike në Kosovë, por edhe për rajonin, duke qenë se nxisin krimin e organizuar dhe terrorizmin, ndërkohë që siguria jonë është e lidhur ngushtë me sigurinë dhe stabilitetin e Bashkimit Evropian. Kjo është hera e parë që institucionet e Kosovës e kanë lansuar vetë këtë proces dhe deri më tash kemi parë interes të madh, por kërkohet edhe mbështetja juaj për promovimin e legalizimit të armëve në mënyrë që përpjekjet tona të jenë vërtet të suksesshme dhe të sigurohet interesi ynë i

nd më të sigurt

përbashkët për një Kosovë më të sigurt.

"Epoka e re": *Deri më tani sa kërkesa për legalizim të armëve ka pranuar MPB-ja?*

Zeka: Deri më sot janë pranuar 539 kërkesa për legalizim dhe nga këto janë dhënë 246 pëlqime. Kërkesat e tjera janë ende në procedurë. Procesi i legalizimit është dizajnuar si i tillë që të ndikojë në uljen e këtij numri të armëve të vogla dhe të lehta.

"Epoka e re": *Cila është procedura për legalizimin e një arme?*

Zeka: Në parim procedurat janë të thjeshta dhe krejt çka duhet të bëjë një qytetar i cili ka një armë dhe dëshiron ta legalizojë atë, duhet të lajmërohet te zyrtari policor në stacionin më të afërt të policisë dhe aty do t'i marrë të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me procedurat që duhen ndjekur për ta legalizuar armën që ka në posedim. Përveç kësaj, ne si MPB do të jemi të gatshëm që të asistojmë në çdo kohë që paraqitet nevoja për ta lehtësuar këtë proces.

"Epoka e re": *A mendoni se është dashur të ketë një fushatë më të madhe nga ana e MPB-së që të ndikojë më shumë në këtë proces?*

Zeka: Fushata është nisur rreth tre muaj më parë dhe Ministria e Punëve të Brendshme me partnerët e vet është duke zbatuar këtë fushatë në përputhje me fondet e disponueshme/të akorduara. Hapa të mëtejshëm për ngritjen e fushatës janë në vazhdim. Jemi të vetëdijshëm se ka ende mundësi që të përmirësohet procesi.

"Epoka e re": *Fushata për legalizim të armëve mbështetet nga misioni i UNDP-së në Kosovë në partneritet me Qeverinë gjermane dhe Zyrën për Punë të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë. Ky bashkëpunim, sa është lehtësues për MPB-në dhe cila është asistenca që japin në këtë proces këta partnerë?*

Zeka: Para së gjithash, më lejoni ta falënderoj Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë për kontributin e dhënë. Dëshiroj ta falënderoj Zyrën e UNDP-së në Kosovë për këshillat teknike gjatë gjithë këtyre viteve në fushën e kontrollit të Armëve të Vogla dhe Lehta (AVL-ve) në tërësi dhe kësaj fushate në veçanti. Mbështetja e tyre ishte dhe është shumë e dobishme. UNDP-ja në vitet e fundit është angazhuar me Ministrinë në fusha si siguria e komunitetit, ekstremizmi i dhunshëm dhe kontrolli i armëve të vogla. Mbështetja e tyre dhe këshilla teknike kanë kontribuar në një strategji dhe plan veprimi të zhvilluar mirë për AVL-të. Qasja e tyre, në bazë të njerëzve, proceseve dhe teknologjisë ka çuar në shërbyes civilë, zbatues të ligjit dhe prokurorë të arsimuar mirë në këtë fushë, në procese shumë të detajuara dhe të zhvilluara mirë, si dhe në teknologjinë e nevojshme për zbatimin e proceseve të detyrueshme për zbatimin me sukses të politikave të lidhura me Armët e Vogla dhe të Lehta.

"Epoka e re": *Përfundimi i këtij procesi, çfarë mesazhi jep për Kosovën?*

Zeka: Kosova është një vend më i sigurt për të jetuar përderisa më shumë armë janë nën kontroll. Po ashtu, Kosova merr përgjegjësinë e saj në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe kontribuon në një rajon më të sigurt.

Flitet për 20 mijë dhunime gjatë luftës, por statusi i viktimës u njihet 301 personave

Prishtinë, 19 mars - Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë konfliktit të fundit në Kosovë (1998-'99), deri më tani ka pranuar mbi 968 aplikacione nga persona që pretendojnë se janë viktima të dhunës seksuale. Nga ky numër, deri më tani janë shqyrtuar 542 raste, 301 personave u njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale, 64 raste janë në shqyrtim, kurse 147 aplikacione të shqyrtuara janë refuzuar. Ndërkaq, ka edhe rreth 400 aplikacione që presin të shqyrtohen. Kështu kanë bërë me dije zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale pas një takimi që kanë zhvilluar me ish-presidenten e Kosovës, Atifete Jahjaga, aktualisht drejtuese e "Fondacionit Jahjaga".

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skendër Reçica, ka thënë se ndër prioritet kryesore të kësaj ministrie ka qenë dhe mbetet përkushtimi për këtë kategori të shoqërisë. "Ne si qeveri na mbetet t'i qëndrojmë pranë Komisionit, ta mbështesim sepse puna e tyre është jashtëzakonisht e ndjeshme. Flitet për trajtimin e dokumentacionit i cili realisht në rrethanat se kur kanë ndodhur krimet dhe kohën në të cilën po trajtohen ato dokumentacione. Bëhet fjalë për një kohë bukur të gjatë. Zotohem se si qeveri do të jemi pranë tyre, t'i mbështesim në kërkesat që t'i lehtësojmë punën me qëllim që të përmbyllet. Edhe ky rast që ka të bëjë më nxjerrjen në dritë të asaj se çfarë realisht ka bërë pushtuesi serb, përveç vrasjeve, dëbimeve dhe shkatërrimeve", ka thënë Reçica, raporton "REL".

Numri i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, sipas institucioneve dhe organizatave që merren me mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie, paraqitet të jetë 20 mijë viktima. Procesi i verifikimit është i domosdoshëm për të përfituar me ligj, të krijuara për këtë kategori. Sipas ligjit, viktimë e dhunës seksuale të luftës është personi i cili i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27. 2. 1998 deri më 20. 6. 1999. Viktima të dhunës seksuale gjatë luftës janë femrat dhe meshkujt, ndonëse numri më i madh i tyre i takon gjinisë femërore.

Çështja e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës është riaktualizuar në kohën e presidentes Atifete Jahjaga, e cila për ta ndihmuar këtë kategori të shoqërisë, në atë kohë krijoi Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale, të cilin e udhëhoqi vetë.

Ish-presidentja Jahjaga ka thënë se synon të sjellë një qasje të re për angazhimin dhe përfaqësimin efikas të grave dhe se përkushtimi për këtë kategori, sipas saj, është përtej institucioneve dhe është detyrë e gjithsecilit në mënyrë që viktimat të mos ndihen të margjinalizuara. Në bazë të ligjit, atyre që u njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës, përfitojnë përfitime personale prej 230 eurosh në muaj.

Ministri Gashi: 'Libri i luftës', projekt historik

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të martën në takim autorin e "Librit të luftës", gazetarin dhe publicistin Nuhi Bytyçi.

Ministri Gashi ka shprehur konsideratën e lartë të tij për punën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të gazetarit të mirënjohur Nuhi Bytyçit në kohë të vështira, veçmas gjatë periudhës së luftës për liri dhe pavarësi. "Të rrallë janë ata gazetarë, sikur ishte Nuhi Bytyçi, i cili në vazhdimësi ishte në shërbim të interesave të publikut, duke rrezikuar vetëm për ta informuar opinionin për zhvillimet dramatike në Kosovë dhe në viset e tjera etnike shqiptare në rrethana të okupimit dhe të terrorit shtetëror serbo-jugosllav, duke thyer censurën e regjimit totalitar komunist, por edhe duke informuar opinionin botëror nga istikamet e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke përçuar mesazhin e luftës së drejtë dhe sakrificën e madhe të popullit shqiptar për liri e pavarësi", ka thënë ministri Gashi.

Ministri Gashi e ka përgëzuar autorin Bytyçi për publikimin e memoareve të tij në një libër voluminoz me titull "Libri i luftës", për të cilin tha se "është një projekt shumë serioz jo vetëm gazetaresk e publicistik, por edhe historik ngaqë në mënyrë kronologjike përfshin të gjitha ato ngjarje dhe zhvillime dramatike të historisë sonë më të re".

Në takim doajeni i gazetarisë së Kosovës, Nuhi Bytyçi, e informoi ministrin Gashi lidhur me përmbajtjen e "Librit të luftës" në botim të Shtëpisë Botuese "Armagedoni". "Puna e gazetarit nuk është aspak e lehtë. Gazetari gjithmonë është në luftë, në luftë për të vërtetën, në shërbim të së mirës së atdheut të tij dhe të njerëzimit, në shërbim të publikut", ka pohuar Nuhi Bytyçi, duke shtuar se kështu e ka kuptuar gjithmonë gazetarinë. "Në këtë frymë jam angazhuar me tërë përkushtimin tim në të gjitha kohët", ka thënë Bytyçi.

Ai ka theksuar se si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i shumë ngjarjeve dhe proceseve politike e ushtarake në Kosovë dhe në mbarë hapësirën etnike shqiptare, që disa vjet ka punuar në prezantimin e tyre në librin "Libri i luftës", i cili është mirëpritur nga opinioni i gjerë. "Besoj se do të shërbejë si dëshmi edhe për historianët tanë të cilët janë duke punuar në shkrimin e historisë sonë më të re kombëtare", ka thënë Bytyçi. Publicisti Nuhi Bytyçi ia dhuroi ministrit Gashi librin e vet dhe e falënderoi për mbështetjen për botimin e librit.

KDI-ja: Thyerja e monopolit për furnizim me materiale të hemodializës shoqërohet me shkelje procedurale

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 MARS - Të gjeturat nga monitorimi i tri kontratave për furnizim me material shpenzues për hemodializë për vitin 2018 janë kornizuar në një raport të cilin Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) e publikoi sot, e që vë në pah faktin që furnizimi me këto materiale ka nisur të zhvillohet me procedura të hapura, megjithatë, është shoqëruar edhe me disa shkelje procedurale.

Në një tryezë diskutimi, ku u shpalosën gjetjet e këtij raporti, Liridona Behrami nga KDI-ja ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë (MSh), për furnizim me material shpenzues për hemodializë për vitin 2018, kishte zhvilluar një procedurë të hapur dhe dy procedura të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë. Behrami ka theksuar se për herë të parë pas më shumë se një dekade, furnizimi me material shpenzues për hemodializë është zhvilluar me procedura të hapura dhe kjo kishte ndodhur me vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP-ja).

Po ashtu, ka theksuar se ky u vlerësua si një hap pozitiv duke u bazuar në faktin se për këto kontrata ishte zhvilluar procedurë e mbyllur një burimore për më shumë se dhjetë vjet, duke i siguruar monopol vetëm një operatori ekonomik. "Procesi i tenderimit për kontratën publike kornizë me procedurë të hapur kishte filluar vetëm dy muaj para skadimit të kontratës paraprake, ndërsa MSh-së i janë dashur tetë muaj për ta përmbyllur këtë proces. Kjo ka ndodhur për shkak të ankesave të shumta të operatorëve ekonomikë në instancën e parë në autoritetin kontraktues dhe në OShP", ka thënë ajo.

Më tej, Behrami ka potencuar se në kontratën e parë me procedurë të negociuar, Ministria e Shëndetësisë nuk kishte shfrytëzuar të gjitha dispozitat e lejuara me ligj për ta rritur konkurrencën dhe për të siguruar çmim sa më të ulët, por kishte lidhur kontratë me një operator ekonomik.

KDI-ja konsideron se çmimet e kontraktuara në këtë kontratë (emergjente) janë të larta duke u bazuar në atë që, me operatorin e njëjtë MSh-ja, pas vetëm disa muajve, nënshkruan kontratë (me procedurë të rregullt) me çmime deri 209 për qind më të lira.

Behrami ka bërë me dije se kjo kontratë, vlera e përgjithshme e së cilës ishte 284 040.00 euro, ishte nënshkruar vetëm nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit përkundër që me nenin 26.2 të Ligjit për Prokurim Publik parashihet që kontratat me vlerë të madhe (mbi 125 000.00 euro) duhet të nënshkruhen përveç nga zyrtari përgjegjës i prokurimit edhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ si dhe nga ministri.

KDI-ja rekomandon që Ministria e Shëndetësisë duhet të sigurohet që procedurat e prokurimit të iniciohen në kohë me qëllim të shmangies së vonesave në proces duke i parashikuar të gjitha procedurat që parasheh Ligji i Prokurimit si dhe të bëjë analizë të tregut me qëllim të sigurimit të çmimit sa më të lirë. Gjithashtu, sipas KDI-së, OShP-ja duhet ta prioritizojë trajtimin e ankesave që burojnë nga tenderët që lidhen me furnizimin e barnave dhe materialeve me rëndësi jetike për shëndetin e qytetarëve.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, në fjalën e tij në këtë tryezë ka thënë se me marrjen e mandatit si ministër ka gjetur një situatë kaotike me furnizim me barna, blerje të jashtëligjshme, çmime të fryra dhe mungesa të mëdha në sistemin shëndetësor. "Me një punë të përbashkët kemi arritur që kontratat e jashtëligjshme të ndërpriten dhe kemi filluar hulumtimin e tregut që të bëjmë krahasime dhe të mos lejojmë që Ministria e Shëndetësisë të blejë barna me çmime shumëfish më të larta se ato që i kemi në barnatoret tona. Kemi arritur që brenda një viti të blejmë barna më lirë për gjashtë milionë euro sesa në vitin paraprak", ka thënë ai.

Sa i përket furnizimit në sektorin e dializës ka shtuar se për herë të parë pas 20 vjetësh Ministria e Shëndetësisë ka hapur tregun për konkurrencë të lirë për furnizim me produkte të hemodializës nga një proces i mbyllur, i negociuar me vetëm një operator si ka qenë në të kaluarën.

Fatmir Limaj viziton kompleksin memorial në Çanakala

Prishtinë, 19 mars (ER) - Në cilësinë e kryesuesit të Komisionit Ndërministror për Kompleksin Memorial "Adem Jashari", zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, së bashku me anëtarë të tjerë të këtij komisioni, Bekim Jasharin dhe Bislim Zogajn, kanë vizituar kompleksin memorial në Çanakala. "Qëllimi i vizitës është për të parë se si vende të ndryshme i pasqyrojnë betejat e tyre dhe për t'i marrë përvojat për memorialët tanë në Kosovë. Komisioni Ndërministror për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari' do të punojë me dinamike të shtuar, në mënyrë që sa më parë të nisë konservimi dhe ndërtimi i Kompleksit Memorial 'Adem Jashari'", ka thënë Limaj në një postim në llogarinë e vet në "Facebook". Limaj ka thënë se beson që nuk ka gjë më të rëndësishme për trashëgiminë historike të Kosovës sesa kompleksi memorial në Prekaz. "Ne besojmë se nuk ka gjë më të rëndësishme për ne si trashëgimi e jona historike sesa kompleksi memorial në Prekaz dhe jam i sigurt se në përfundim të këtij projekti, të gjithë do të ndihen krenarë me punën që do të bëhet", ka thënë Limaj.

Ambasadorët e BE-së informohen për zhvillimet në sundimin e ligjit

Ambasadorët e vendeve të Bashkimit Evropian (BE) janë informuar të martën nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, rreth sundimit të ligjit në Kosovë, që kanë qenë të diktuara nga tre përbërës themelorë: rekomandimet e Komisionit Evropian të shprehura në raportet e vendit, përmbushja e Agjendës së Reformave Evropiane, si dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 19 mars - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka takuar të martën ambasadorët e vendeve të Bashkimit Evropian me të cilët ka diskutuar për sundimin e ligjit në Kosovë. Me këtë rast, ministri Tahiri i ka njoftuar ambasadorët për reformat e ndërmarra legjislative të këtij sektori që, sipas tij, kanë qenë të diktuara nga tre përbërës themelorë: rekomandimet e Komisionit Evropian të shprehura në raportet e vendit, përmbushja e Agjendës së Reformave Evropiane, si dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Tahiri ka përmendur ndryshimet e bëra në Kodin e ri Penal, reformimin e politikës së parandalimit të konfliktit të interesit përmes Ligjit të ri që rregullon këtë fushë, Pakon Kundër Korrupsionit si dhe Pakon e ligjeve të gjyqësorit. Sipas ministrit Tahiri, ndryshime thelbësore janë bërë edhe në Draft Kodin e Procedurës Penale, ndërsa aktualisht po punohet në Projektligjin për Deklarim të Pasurisë. "Po shqyrtojmë listën e deklaruesve, për të bërë subjekte deklarimi secilën pozitë ku ka potencial për abuzim. Jemi duke vendosur standarde të reja uniforme sa iu përket të dhënave të deklaruara dhe jemi duke vendosur mekanizma të mirëfilltë të matjes së saktësisë së të dhënave të deklaruara që Agjencia do t'i ketë në dispozicion për verifikim", ka theksuar Tahiri.

Ministri Tahiri ka përmendur edhe agjendën e përbashkët "Drejtësia 2020", e cila synon të adresojë pesë probleme themelore: reduktimin e back-logut, plotësimin e kapaciteteve, koordinimin ndërinstitucional, rritjen e performancës dhe përgjegjësisë së organeve të pavarura të zbatimit të ligjit si dhe zbatimin efikas të ligjeve. Ndonëse janë pushtete të ndara, ministri Tahiri ka theksuar se bashkëpunimi me "Drejtësia 2020" është bërë për ta rritur dhe për ta përmirësuar në përgjithësi sistemin e drejtësisë. "Angazhimi i përbashkët i institucioneve të sistemit të drejtësisë në këtë agjendë është bërë mbi bazën e nevojës për një koordinim më të mirë dhe për një vetëdijesim më të madh ndërinstitucional për zbatimin e ligjit, gjithmonë duke ruajtur pavarësinë, pacenueshmërinë dhe individualitetin e secilit prej institucioneve të këtij sistemi", është shprehur Tahiri, duke shtuar se, përveç në këtë agjendë, do të punohet edhe në procesin e rishikimit funksional, për t'i parë nga afër problemet dhe për të gjetur zgjidhje afatgjatë. "Krahas 'Drejtësia 2020' dhe agjendës legjislative, këtë vit do të punojmë shumë për të përmbyllur me sukses procesin e Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, proces i cili ka filluar tash një vit dhe ngërthen në vete procesin koordinues dhe reformues më gjithëpërfshirës në sektorin e sundimit të ligjit", ka thënë ministri Tahiri.

LDK-ja kërkon debat parlamentar për aksidentet në komunikacion

Prishtinë, 19 mars (ER) - Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka vlerësuar se rritja e numrit të aksidenteve në komunikacion, të cilat po përfundojnë shumë shpesh me vdekje, lëndime të rënda trupore dhe dëme të mëdha materiale, janë bërë dukuri shumë shqetësuese në Republikën e Kosovës.

Sipas një komunikate të kësaj partie, kontrollimi dhe monitorimi i gjendjes teknike të automjeteve që qarkullojnë në rrugët e vendit tonë, bazuar në numrin në rritje të aksidenteve, është dëshmi se nuk po bëhet konform ligjeve të miratuara. "Bazuar nga sa u tha më lart, grupi parlamentar i LDK-së ka dorëzuar sot kërkesën për debat parlamentar në të cilin do të debatohet lidhur me aksidentet në komunikacion që po përfundojnë me vdekje, lëndime të rënda trupore dhe dëme materiale, mosrespektim të ligjeve të miratuara që rregullojnë fushën e qarkullimit në komunikacion, gjendjen teknike të automjeteve dhe trajnimin e shoferëve rinj", është thënë në komunikatën e LDK-së.

Oda Amerikane mirëpret takimet me përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë

Prishtinë, 19 mars (ER) - Tregtia e lirë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, e mundësuar nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilim-Asociimit, ka rezultuar në një klimë më të favorshme të të bërit biznes në përgjithësi dhe ka ekspozuar Kosovën në një treg të madh. Kështu thanë anëtarët e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë gjatë takimit me Nataliya Apostolovën, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe përfaqësuese speciale e BE-së.

Anëtarët e Odës Amerikane po ashtu diskutuan rreth vështirësive për gjetjen e partnerëve potencialë në biznes, për përmirësimin e shkathtësive në punë dhe për zhvillimin e ideve inovative të biznesit.

Ambasadorja Apostolova ka njoftuar të pranishmit me prioritetet e Zyrës së BE-së në Kosovë, duke theksuar Agjendën për Reforma Evropiane, sundimin efektiv të ligjit, reformat në administratën publike, si dhe investimet në sektorin e arsimit si kyç në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo ka falënderuar Odën Amerikane për dhënien e rekomandimeve për raportin vjetor të Komisionit Evropian.

Ambasadorja Apostolova ka mirëpritur vazhdimin e bashkëpunimit me sektorin privat në Kosovë.

Presidenti i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, Ilir Ibrahimi, ka thënë se Oda Amerikane ka ngritur shumë çështje sa i përket sektorit privat në Kosovë, duke ftuar Zyrën e BE-së për zhvillim të bashkëpunimit në mes të institucioneve të bizneseve, duke arritur rritje ekonomike më të qëndrueshme në Kosovë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, duke përmendur prioritetet e Odës Amerikane në avokimin për çështje ekonomike, ka thënë se Oda Amerikane mirëpret takimet për ta rritur bashkëpunimin mes sektorit privat dhe Zyrës së BE-së në Kosovë, pasi kjo është esenciale për zhvillimin e bizneseve në Kosovë.

Ministria e Infrastrukturës financon projektet infrastrukturore lokale në Prizren

Prishtinë, 19 mars (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka pritur të martën në një takim pune kryetarin e Prizrenit, Mytaher Haskuka, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projekteve të reja infrastrukturore lokale në këtë komunë.

Komuna e Prizrenit me anë të kësaj marrëveshje me MIT-në përfiton 400 000 euro për vitin 2019. Lekaj dhe Haskuka nënshkruan edhe aneksin e memorandumit paraprak për financim të projekteve që veçse janë duke u zhvilluar në Prizren. MIT-ja merr përsipër financimin e asfaltimit të rrugës

Lubizhdë - Skrobizhdë, ku për këtë vit janë ndarë mjetet prej 50 000 eurosh dhe për asfaltimin e rrugës Prizren - Velezhë në vlerë prej 50 000 eurosh.

Ministri Lekaj ka kërkuar nga kryetari Haskuka që realizimi i projekteve të financuara nga dikasteri që ai drejton të bëhet me cilësi dhe sipas afateve kohore të parapara. Ai i ka premtuar kryetarit se mbështetja nga niveli qendror i qeverisjes, pa dallim bindjesh, nuk do të mungojë edhe në të ardhmen. I pari i MIT-së e njoftoi kryetarin e Prizrenit se për këto projekte janë të parapara edhe mjetet buxhetore për vitet që pasojnë deri në realizimin final të tyre.

Ndërkaq e informoi të parin e kësaj komune se shumë shpejt do të fillojnë investimet edhe në hyrjen e Prizrenit nga ana e Gjakovës, projekt ky që financohet nga kredia e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Kryetari i Prizrenit e ka falënderuar ministrin për këtë mbështetje, duke u zotuar se projektet e financuara nga MIT-ja do të realizohen në afatet e parapara. Ai ka shtuar se mbështetja për komunën që ai drejton, nënkupton mbështetje për qytetarët të cilëve po u kthehen taksat nëpërmjet investimeve në infrastrukturë.

Qeveria miraton Strategjinë Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi 2019-2023

Prishtinë, 19 mars (ER) - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi për periudhën 2019-2023. Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, gjatë propozimit të kësaj strategjie, ka deklaruar se kjo strategji do ta mundësojë realizimin e objektivave që lidhen me inovacionin. "Objektivat strategjike janë zhvillimi i një sistemi për inovacion, rritja për inovacion, mbështetja e të rinjve dhe grave në biznese. Synimi i ministrisë sonë është stimulimi i aktiviteteve inovative dhe me miratimin e kësaj strategjie mundëson realizimin e objektivave tona", ka thënë ministri Beqaj.

ASK-ja: Niveli i papunësisë, 31.4 për qind

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkalla e papunësisë për tremujorin e katërt të vitit 2018 është 31.4 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24-vjeçare, me 57.3 për qind, kurse fuqia joaktive është mjaft e lartë me 58 për qind, me fokus të veçantë te femrat me 79.5 për qind, krahasuar me meshkujt 36.1 për qind

Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 19 mars - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të martën rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për tremujorin e katërt (TM4) 2018. Sipas ASK-së, dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune. Në kuadër të popullsisë në moshë të punës, ku përfshihen moshat 15-64-vjeçare, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 42 për qind.

Anketa ka pasur shtrirje në 600 qarqe regjistruese në tërë territorin e vendit, ku janë anketuar 3 488 ekonomi familjare, të përzgjedhura sipas metodës së rastit, nga korniza e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2011. Ekonomitë familjare, të selektuara për anketim, përveçse kanë pasur një anketim, ato kanë pasur edhe tri rianketime sipas periudhës referuese.

Ky publikim përmban të dhëna mbi punësimin dhe papunësinë sipas moshës, gjinisë, statusit të punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe çështje të tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me tregun e punës. "Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore për TM4 2018 është 28.8 për qind, ndërsa punësimi më i lartë është te meshkujt 45.2 për qind, kurse punësimi te femrat është 12.7 për qind. Femrat janë të punësuara, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 52.9 për qind, ndërsa meshkujt në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit, me 44.1 për qind. Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë tregtia me 17 për qind, ndërtimtaria me 12.1 për qind, prodhimi me 11.1 për qind, arsimi me 10.6 për qind, ndërsa sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim", thuhet në raportin e ASK-së. Sipas ASK-së, sa iu përket të punësuarve me kontrata, del se 33.8 për qind e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 66.2 për qind kanë kontratë të përkohshme. Sipas ASK-së, shkalla e papunësisë është 31.4 për qind, ku më e theksuar është te femrat me 38 për qind, krahasuar me meshkujt 29.2 për qind. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24-vjeçare me 57.3 për qind, kurse fuqia joaktive është mjaft e lartë me 58 për qind, me fokus të veçantë te femrat me 79.5 për qind, krahasuar me meshkujt, 36.1 për qind.

Për realizimin e AFP-së, TM4 2018, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostatit.

Kapet një sasi e konsiderueshme e medikamenteve gjatë tentimkontrabandës

Prizren 19 mars (ER) - Oficerët doganorë gjatë kontrollimit të një maune kanë zbuluar sasi të konsiderueshme të medikamenteve të mbështjella me mbulesa për tavolina dhe perde. Sipas një njoftimi të Doganës, gjatë kontrolleve te mallrat në import kjo dërgesë është selektuar për kontroll të hollësishëm, ku gjatë kontrollimit të maunës, e deklaruar si përmbajtje tekstili, janë hasur sasi të konsiderueshme të medikamenteve të cilat, përveçse ishin në tentim për kontrabandë, nuk plotësonin as kushtet higjienike dhe temperaturat për transport. "Sasia e medikamenteve ishte rreth 700 paketime me vlerë afër 15 000 mijë euro. Me këtë rast, për shkak se importuesi ka bërë shkelje të dispozitave të KDAK-së, neni 276, pika A, ndaj të njëjtit është iniciuar proces për kundërvajtje si dhe rasti vazhdon për hetime të mëtejme", është thënë në njoftimin për media të Doganës.

Fermerët e Drenasit priten të trajnohen nga Ministria e Bujqësisë

Drenas, 19 mars (ER) - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Drenas ka njoftuar të gjithë fermerët aplikues potencialë për grante, se në vitin 2019 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjegjësisht Shërbimi Këshillimor i kësaj ministrie, ka planifikuar të njoftojë për trajnime të ndryshme për fermerë. Me këtë rast, Komuna e Drenasit ka ftuar fermerët e kësaj komune që për informata shtesë rreth aplikimit për grante të paraqiten në Drejtorinë e Bujqësisë. "Fermerët të cilët janë të interesuar për grante të paraqiten në Drejtorinë e Bujqësisë në Drenas deri më 22 mars çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00, për të marrë informata më të hollësishme dhe për të vazhduar rreth aplikimeve të granteve", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

Publikohet hulumtimi 'Siguria në shkollat e qytetit të Kaçanikut'

Kaçanik, 19 mars (ER) - Përfaqësues të institucioneve komunale, drejtori i Arsimit dhe Kulturës, Zahir Doda, përfaqësues të stacionit të policisë në Kaçanik, drejtorë shkollash, përfaqësues të këshillit të prindërve, janë takuar për të diskutuar për gjendjen e sigurisë në shkollat e Komunës së Kaçanikut. Në këtë takim është publikuar edhe raporti i hulumtimit me titull 'Siguria në shkollat e qytetit të Kaçanikut', realizuar nga stacioni policor në Kaçanik.

Ky hulumtim është bërë me qëllim të ofrimit të një ambienti sa më të sigurt, largimin e dukurive negative dhe ngritjen e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së punës policore në përgjithësi. Në këtë hulumtim janë dhënë edhe disa rekomandime, ku nga të pranishmit në takim u kërkua që këto rekomandime të zbatohen, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të qetë dhe të sigurt në shkolla për fëmijët e tyre.

Në mesin e rekomandimeve në këtë hulumtim është edhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes të policisë, Drejtorisë së Arsimit, drejtorëve të shkollave, prindërve dhe nxënësve, organizimi i ligjëratave të ndryshme, shpërndarja e fletushkave, mbajtja e aktiviteteve të tjera me qëllim të parandalimit të dukurive negative etj.

Nënshkruhet marrëveshja për 'Ndërtimin e pikës së vetme të kontaktit ONE STOP SHOP' në Prizren

Prizren, 19 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për realizimin e projektit kapital për 'Ndërtimin e pikës së vetme të kontaktit ONE STOP SHOP' në Prizren. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari Haskuka ka thënë se Prizreni është komuna e parë me një projekt të tillë, me të cilin do të rregullohet ambienti në hyrje të administratës komunale dhe do të mundësohet që shërbimet që jepen nga komuna të jenë sa më të lehta dhe të qasshme për qytetarët. "Këtu faktikisht do të jenë të gjitha shërbimet, nga certifikatat më të lehta, deri te aplikimi për leje ndërtimore, apo procedurat e tjera më të komplikuara, ku qytetarëve s'do t'u kërkohet që të enden zyrave të komunës lart e poshtë, por do të jenë të gjitha në një vend", ka thënë Haskuka.

Kurse ministri Jagxhillar ka thënë se me këtë projekt të rëndësishëm po krijohet një vazhdimësi e reformave dhe modernizim i administratës publike në nivelin qendror dhe në atë lokal, nëpërmjet të cilit qytetarët do të kenë mundësi të marrin shërbime të ndryshme në një vend.

Ky projekt, i cili po realizohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Komuna e Prizrenit, ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit për qytetarët dhe konsumatorët.

Vlera e projektit parashihet të jetë rreth një milion euro, për të cilin Komuna e Prizrenit do të financojë 50 mijë euro, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal deri në 200 mijë euro, kurse Ministria e Administratës Publike do ta financojë pjesën tjetër të projektit deri në finalizim.

Komuna e Malishevës nënshkruan kontratë dyvjeçare për grumbullimin e mbeturinave

Malishevë, 19 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ushtruesi i shefit të prokurimit, Nuhi Shala, me bashkëpunëtorë të njësisë së "Ekoregjionit" në Malishevë, dhe drejtori nga Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ekoregjioni" sh. a. me seli në Prizren, Nehat Basha, kanë nënshkruar kontratën dyvjeçare për grumbullimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike dhe objektet publike. Me këtë rast, kryetari Begaj ka shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit dhe ka ofruar tërë potencialin që ka si në kapacitetet njerëzore dhe ato motorike, me qëllimin e vetëm, që qytetarëve të Malishevës t'u krijohen hapësira dhe ambiente të pastra publike.

Begaj i ka ftuar të gjithë qytetarët dhe bizneset që së bashku të përkujdesen për ambient të pastër. Kurse Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ekoregjioni" sh. a. me seli në Prizren do të merret me të gjitha detyrat e përshkruara në specifikacionin nga Komuna e Malishevës: pastrimin, larjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve të qytetit, grumbullimin e mbeturinave çdo ditë dhe transportin e tyre në gjithë territorin e komunës dhe hapësirat publike.

Taksa 100 për qind dhe lulet e xhenetit

Jakup KRASNIQI

Të gjithë ata që taksën 100 për qind e shohin pengesë për, kinse, një marrëveshje të pretenduar me Serbinë, "janë në lule të xhenetit"!
Iu takon, sidomos atyre që thirren në vlera demokratike, që të bëhen burra ose burrnesha e të na tregojnë: Pse marrëveshjen që kaq shumë po e dëshirojnë në mes të Kosovës e Serbisë nuk e arritën para nëntorit të vitit 2018? Nuk ka dyshim, taksën e kanë si pretekst, po cilët ishin pretekstet para taksës?
Dëgjoni e lexoni, kuptohet nëse keni sy për të parë e veshë për të dëgjuar, se çka na përrallisin disa herë brenda një dite çinovnikët e lartë të Serbisë për Kosovën e shqiptarët? Kërcënimet që i bëjnë edhe tani janë po të njëjtës natyrë si ato të viteve të luftës kur ia patën vu zjarrin Kosovës. Pra, se çka mendojnë ata kriminel e kemi parë sidomos në vitet 1998 dhe 1999. Ketë askush nuk po e thotë! Nuk po shkojmë më larg në histori se bëhet tepër, por as sot nuk mendojnë ndryshe për shqiptarët e Kosovës. A e dinë ata në BE, pse ishte formuar Tribunali i Hagës për krimet në ish Jugosllavinë? Nëse kanë harruar, shqetësohem për ata që e kanë kujtesën e shkurtër! Në Kosovë ka shumë njerëz në politikë me kujtesë shkurtër. Besonim se në BE njerëzit mendojnë ndryshe.
Të gjithë e dinë se, taksa nuk ishte aty nga viti 2011 e krejt deri në fund të vitit 2018 kur janë zhvilluar bisedimet e Brukselit dhe nuk u arrit asnjë marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi!
Nuk me habisin shumë ata të jashtmit, pasi ata në fund të fundit nuk janë prekur nga krimi e gjenocidi që e jetuam në Kosovë, por me habisin këta tanët, që kurrë nuk qenë të zotet që ta "trembin macen nga përsheshi" dhe i pengon taksa! Bile po me vije goxha keq pse janë bërë kaq shumë këta të fundit. Madje fare pa u skuqur po defilojnë nga një ekran televiziv në tjetrin?!
Qyqarë, bota gjithherë ka pasur, por edhe tash po vazhdon t'i ketë me bollëk.
Pa dyshim, njerëzit me integritet, dije dhe dinjitet gjithnjë e kudo kanë qenë në pakicë, si dje ashtu edhe sot, nuk ka ndonjë ndryshim në substancë. Ishte një kohë që ata, të paktët që kishin integritet e vizion, ndiqeshin nga shumica! Tani është koha e zhurmërisë së shumicës!
Prej atyre që jetonin e jetojnë në "lule të xhenetit" me zhurmëri, nuk e pres ditën e selametit.

20 vjet nga vrasja e gazetarit dhe profesorit Sabit Veliu bashkë me mikun e tij, aktivistin Musli Shala



Skenderaj, 19 mars (ER) - Sot (e mërkurë) bëhen 20 vjet nga vrasja e gazetarit, shkrimtarit dhe aktivistit të shquar të çështjes shqiptare, Sabit Veliu, bashkë me mikun e tij, aktivistin Musli Shalën nga forcat serbe.
Në mëngjesin e 20 marsit ushtria dhe njësitet speciale e paramilitare serbe me arrogancën më të madhe depërtuan nëpër një numër të madhe të shtëpive në lagjet e Skenderajt, e ndër to edhe në shtëpinë e sekretarit të Shkollës së Mesme Teknike "Anton Çetta", Dibran Shalës. Aty pasi keqtrajtojnë familjarët, dhe pasi bastisin nëpër shtëpinë e Dibranit, arrestojnë dhe marrin me vete djalin e tij, Musliun, si dhe dhëndrin e tij, profesorin e gjuhës angleze dhe aktivistin e të drejtave të njeriut, Sabit Veliun.
Në këtë datë të 20 vjetëve më parë nëpër disa shtëpi policia serbe kishin marrë edhe disa të rinj tjerë si: Lavdim Vojvodën nga Llausha 20-vjeçar (nxënës i Sabitit), xhaxhanë e tij, Nebih Vojvodën dhe mikun e tij Sadik Gashin nga Tërsteniku, Januz Kallecin dhe djalin e tij Xhavit Kallecin nga Polaci dhe Ramiz Gecin nga Llausha. Familjarët kujtuan se po i dërgonin në stacionin policor për arrestim, por Sabitin e Musliun së bashku me gjashtë të tjerë barbarët serbë i ekzekutojnë te pishat sipër Skenderajt, kurse kufomat i bartin dhe i dërgojnë në morgun e spitalit në Mitrovicë. Për vrasjet dhe vendndodhjen e tyre familjarët ishin njoftuar përmes telefonatave nga mërgimtarët atë ditë të kobshme në mbrëmje. Në lajmet e publikuara serbe, që kishin depërtuar në televizionet perëndimore, ishte njoftuar se policia serbe kishte kapur e vrarë tetë "terroristë" shqiptarë në Skenderaj, duke ua cituar emrat, datat dhe vendlindjet e tyre, ndër ta edhe "diversantin e UÇK-së" siç e kishin quajtur Sabitin ata, kufomat e të cilëve ndodhen në morgun e spitalit në Mitrovicë. E ëma e Musliut, tashmë e ndjerë, Zelfija, me të bijën, Sabrijen, edhe karshi rreziqeve, të nesërmen shkojnë në spitalin e Mitrovicës, i tërheqin kufomat me ndihmën e disa banorëve të atjeshëm dhe i varrosin në varrezat e fshatit Shupkofc në Mitrovicë.
Sabit Veliu së bashku me mikun e tij, Musli Shala, ishin pjesëmarrës në protestat e demonstratat që organizoheshin për çështjen e Kosovës. Sabit Veliu kishte punuar një kohë të gjatë gazetar në Televizionin e Zagrebit. Veliu punoi profesor i gjuhës angleze në Shkollën e Mesme Teknike "Anton Çetta" në Skenderaj. Ishte përkthyes i gjuhës angleze si dhe aktivist në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Veliu merrej edhe me shkrime. Dy nga botimet e tij janë: "Fjalor anglisht-shqip për shkollat e mesme (me rreth 3 000 fjalë)" dhe "Antologjia e fjalëve të urta", nga mendimtarë të njohur.
Në vendin e quajtur "Te Pishat" në Skenderaj, në nderim të profesorit Sabit Veliut e Musli Shalës dhe gjashtë të rënëve të tjerë është ngritur një pllakë përkujtimore.

E rrallë

Presidenti bllokohet për katër orë në tren

Presidenti i Afrikës së Jugut, Cyril Ramaphosa, mund të ketë shpresuar se bashkimi me udhëtarët e mëngjesit do ta ndihmonte për zgjedhjet e majit. Ky plan nuk mund të quhet një ogur i mirë për të. Ai dhe udhëtarët e tjerë mbetën të bllokuar në tren për katër orë, ndërkohë që udhëtimi duhet të përfundonte për 45 minuta. "Është e papranueshme", ka thënë presidenti Ramaphosa pasi treni arriti në vendin e vet.

FOTO E DITES

Disa punëtorë shihen duke punuar një mbulesë prej hekuri në Colombo, Sri Lanka. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Turistët futin në 'krizë sigurie' qytetin e vogël

Një qytet në Kaliforninë e Jugut u detyrua ta ndalonte përkohësisht hyrjen e turistëve që vizitonin një lulëzim të jashtëzakonshëm, i ashtuquajtur "super bloom", pasi vunë në rrezik sigurinë publike. Zyrtarët e liqenit Elsinore mbyllën të dielën Walker Canyon, duke folur për një 'krizë të sigurisë publike', pasi vizitorët shkelën lulet dhe shkaktuan bllokim të trafikut. Qyteti me 66 000 banorë priti rreth 50 000 turistë fundjavën që lamë pas.

BARSOLETA E DITËS

Një ditë nëna e pyet vajzën e vet:
- Sa bëjnë 2+3?
- Gjashtë.
- Je e sigurt?
- Po.
- Për këtë arsye ke marrë notën 4.
- Aha, tani e kuptova që 2+3 bëjnë 4.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Sot do ta keni mundësinë të ballafaqoheni me një person me të cilin keni debate të vazhdueshme. Do të sqaroni shumë gjëra.

DEMI Një dëshirë e madhe për normalitet dhe për projekte konkrete. Ka ardhur koha të mendoni një zgjidhje më të përshtatshme për veten.

BINJAKËT Çdo dëshirë e juaja është një urdhër në këtë periudhë. Thjesht, duhet ta përmirësoni disi mënyrën e të kërkuarit të gjërave.

GAFORRJA Keni lënë shumë gjëra pezull dhe nuk po gjeni dot mënyrën për t'u organizuar. E gjithë kjo situatë do t'ju penalizojë.

LUANI Çastet e vogla të kënaqësisë sot janë ato që do ta bëjnë diferencën në rutinën e ditës dhe që do t'ju japin energji pozitive.

VIRGJËRESHA Nuk dini të gënjeni, kështu që gjatë drekës duhet t'u jepni përgjigje të sakta personave që do të kërkojnë informacion nga ju.

PESHORJA Keni çështje burokratike ose administrative për të zgjidhur sot. Mos humbni kohë duke kërkuar zgjidhje vërdallë. E dini se çfarë duhet të bëni.

AKREPI Eprorët tuaj kanë filluar të dyshojnë nëse jeni vërtet i aftë ta bëni punën si duhet si pasojë e disa vonesave të vërejtura kohët e fundit te ju.

SHIGJETARI Ndryshojeni ritmin e ditës duke organizuar një takim me miqtë, duke shikuar një film në kinema ose diçka tjetër të këndshme.

BRICJAPI Mposhteni shumë shpejt nga emocionet dhe kjo gjë nuk ju lejon ta shihni realitetin që ju ofrohet. Duhet të logjikoni në mënyrë racionale.



UJORI Personat që ju kanë pezmatuar do t'i nxirrni përfundimisht nga jeta juaj. Jeni drastike në marrjen e vendimeve, por kjo ndodh veç kur lëndoheni.

PESHQIT Sot planetët i keni në anën tuaj dhe ju premtojnë një fillim jave të mbarë. Gjithsesi ju duhet të lini më shumë hapësirë për jetën familjare.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	POTENZA - SICULA LEONZIO	1	GJERMANIA - SERBIA	1-1	UNTERHACHING - COTTBUS	GG3+

Sejdiu: Kosova duhet të luajë për fitore ndaj Danimarkës dhe Bullgarisë

Trajneri Gani Sejdiu është shumë optimist se Kosova mund të arrijë fitore ndaj Danimarkës në miqësore dhe Bullgarisë në kualifikuese pasi ka potencial të madh dhe forma e lojtarëve është në nivel të lartë. "Kosova s'bën të kërkojë barazim, sidomos kur luan vendëse. Nuk besoj se barazimi është i mjaftueshëm, prandaj lojtarët duhet të luajnë me kujdes të madh. Pas suksesit në Ligën e Kombeve, jemi në një fazë tjetër dhe kemi potencial për të kërkuar më shumë. Tjetër gjë është kur luajmë ndaj Anglisë, por ndaj Bullgarisë duhet ta kërkojmë maksimumin, edhe pse është një kombëtare me traditë, por që tash është në fazën e tranzicionit", ka thënë Sejdiu

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është në prag të dy ndeshjeve të para për vitin 2019. "Dardanët" fillimisht do të luajnë në miqësore ndaj Danimarkës, kurse më pas do ta presin Bullgarinë, në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020". I kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", trajneri Gani Sejdiu ka thënë se miqësorja e 21 marsit është shumë e rëndësishme për Kosovën dhe trajnerin Bernard Challandes, pasi do të shihet potenciali që ka para ndeshjeve kualifikuese në "Euro 2020". "Ndeshja me Danimarkën është një test i rëndësishëm për përfaqësuesen e Kosovës, pasi është në momentin më të mirë për lojtarët tanë, të cilët do të kenë përballë një kundërshtar të nivelit të lartë. Edhe kundërshtarët në grupin kualifikues që ka Kosova janë të nivelit të lartë sikurse Danimarka dhe kjo ndeshje do t'u shërbejë shumë përfaqësueseve. Ajo që ka rëndësi të madhe në këto çaste është fakti se të gjithë lojtarët e Kosovës po tregojnë formë të lartë nëpër klube. Duhet të besojmë se përfaqësuesja po rritet sikurse edhe lojtarët nëpër klubet dhe ligat ku paraqiten. Duhet të luajnë për fitore, ani pse rezultati nuk është shumë i rëndësishëm, pasi është ndeshje miqësore. Selektori do ta ketë mundësinë që në këtë ndeshje të përgatisë edhe ndeshje me Bullgarinë", ka thënë Sejdiu.

Trajneri që ka fituar dy herë titullin e kampionit në Kosovë është shumë i lumtur që futbollistët po tregojnë formë të lartë nëpër klubet e tyre. "Zeneli ka kaluar nga niveli i kampionatit holandez në një kampionat më të fortë siç është ai i Francës, sikurse që ka bërë më herët edhe Milot Rashica, i cili tash është ambientuar mirë dhe po tregohet vendimtar për klubin e Bremenit. Mos të harrojmë edhe paraqitjet e Celinës, Muriqit dhe të tjerëve", ka shtuar ai.

Më pas ish-trajneri i Trepçës, Feronikelit, Besës dhe Trepçës '89 foli edhe për ndeshjen ndaj Bullgarisë, ku deklaroi se futbollistët "Dardanë" duhet të luajnë vetëm për fitore kur ndeshjet zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri". "Kosova s'bën të kërkojë barazim, sidomos kur luan vendëse. Nuk besoj se barazimi është i mjaftueshëm, prandaj lojtarët duhet të luajnë me kujdes të madh. Pas suksesit në Ligën e Kombeve, jemi në një fazë tjetër dhe kemi potencial për të kërkuar më shumë. Tjetër gjë është kur luajmë ndaj Anglisë, por ndaj Bullgarisë duhet ta kërkojmë maksimumin, edhe pse është një kombëtare me traditë, por që tash është në fazën e tranzicionit", ka thënë Sejdiu.

Kosova zhvillon stërvitjen e dytë

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të martën e zhvilloi edhe stërvitjen e dytë. Ashtu sikurse stërvitjen e parë, "Dardanët" e kryen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Trajneri Bernard Challandes fillimisht aplikoi një vrapim të lehtë e më pastaj futbollistët kanë zhvilluar ushtrime taktike me top. Kosova ndeshjen e parë e zhvillon të enjten ndaj Danimarkës në orën 19:00, kurse ndeshjen e dytë e zhvillon ndaj Bullgarisë të hënën nga ora 20:45.

SHKURT

Besa Famgas - Prishtina, derbi i mesjavës

Besa Famgas - Prishtina është derbi i javës së 22-të të Superligës A të Kosovës në hendboll (meshkujt). Xhiroja e 22-të luhet sot (e mërkurë). Besa e Prishtina takohen në palestrën "Karagaçi" në Pejë nga ora 18:00. Kampionia aktuale, Besa Famgas, është kthyer në vend të parë të shtunën pas fitores së thellë ndaj Vushtrrisë. Besa i ka 38 pikë aq sa edhe Kastrioti i vendit të dytë. Prishtina është e treta me 32 pikë. Prishtina e ka befasuar Besën në vjeshtë, duke ia shkaktuar njërën prej dy humbjeve në këtë kampionat. Shpresohet në ndeshje të fortë e cilësore të dy prej skuadrave pretendente. Nga ora 18:00 takohen edhe Kastrioti dhe Drita në Ferizaj. Drita është e katërta me 20 pikë, ndërsa të gjitha i ka fituar në vjeshtë. Nga ora 20:00 luhet ndeshja Vushtrria - Vëllaznimi. Vushtrria është e gjashta me 17 pikë, kurse Vëllaznimi i pesti me 18 pikë.

Kosova për herë të parë organizon turneun evropian të tenisit

Federata e Tenisit e Kosovës për herë të parë ka fituar të drejtën për ta organizuar turneun e Federatës Evropiane të Tenisit në Kosovë, i cili mbahet për kategorinë e tretë të grupmoshës U-16. Turneu do të mbahet prej 2-8 shtatorit në Brestovik të Pejës. Federata Evropiane e Tenisit përmes faqes zyrtare në "Twitter" ka konfirmuar mbajtjen e këtij turneu në vendin tonë. "Do të donim ta mirëprisnim ngjarjen e parë ndërkombëtare të Federatës Evropiane të Tenisit në Kosovë për kategorinë juniore", thuhet në njoftimin e FTE-së.

Bologna, Spali dhe Torino e kërkojnë Dermakun

Kastrioti Dermaku ishte grumbulluar më parë gjatë Ligës së Kombeve në Kombëtare nga trajneri Christian Panucci, por tash nuk mori një ftesë për ndeshjet e marsit ndaj Turqisë dhe Andorrës. Por, tashmë emri i Binakut lakohet në Serinë A, pas formës së mirë. 27-vjeçari ka qenë një shtyllë e rëndësishme për ekipin e tij, duke luajtur në 26 takime, e humbur vetëm dy të tilla. Tashmë ai është në radarët e Bolongës, Spalit dhe Torinos, si një alternativë e mundshme në merkato.

Shaqiri largohet nga Zvicra, shkak lëndimi

Futbollisti me origjinë shqiptare, Xherdan Shaqiri, është larguar nga kombëtarja e Zvicrës dhe do të mungojë në dy ndeshjet kualifikuese të Evropianit kundër Gjeorgjisë dhe Danimarkës. Shkak është bërë një problem shëndetësor që Shaqiri ka hasur së fundmi. 27-vjeçari nga Gjilani ka ndjerë dhimbje në zonën e gjoksit dhe është detyruar ta braktisë ekipin kombëtar. Shaqiri nuk është aktivizuar javën e fundit me skuadrën e Liverpulit por, pavarësisht kësaj, ai është pjesë e rëndësishme e klubit anglez, teksa problemet e tij shëndetësore kanë alarmuar edhe klubin e kuq.

Foto Strakosha: E respektoj vendimin e Panuccit

TIRANË, 19 MARS - Trajneri i Kombëtares, Christian Panucci, la jashtë grumbullimit Thomas Strakoshën, i cili humbi avionin për të mbërritur me kohë në grumbullim në Durrës. Për këtë, pas publikimit të lajmit ekskluziv, "Panorama Sport" ka kontaktuar ekskluzivisht edhe me babanë menaxher të portierit, Foto Strakoshën, ish-kapitenin e Shqipërisë. Në bisedën telefonike, ish-gardiani i kuqezinjve kërkon me çdo mënyrë t'i shmangë keqkuptimet për situatën e krijuar, pasi në kryefjalë të asaj që thotë është Kombëtarja, edhe kur bëhet fjalë për të birin. "Më mirëkuptoni, por e kam të vështirë të flas. Pavarësisht gjithkujt, kombëtarja është mbi të gjithë", ka thënë Foto Strakosha. "Edhe në karrierën time, por në të gjithë jetën time, mbi çdo gjë, ka qenë ekipi kombëtar. Dhe për ta respektuar edhe momentin e ekipit kombëtar që ka ndeshjen të premten, duke marrë shkas edhe që unë jam prind, babai i Tomasit, nuk do të jem i bindshëm për asnjë. Kështu që, unë jo vetëm e kam për detyrë, por sinqerisht e respektoj vendimin e trajnerit", ka deklaruar Foto Strakosha.

Basha: T'u mësojmë të rinjve dashurinë për kombëtaren

TIRANË, 19 MARS - Migjen Basha ishte një nga futbollistët e përzgjedhur për të dalë para gazetarëve në konferencën për shtyp të ditës së dytë të grumbullimit të kombëtares shqiptare. Mesfushori foli me superlativa për atmosferën në ekip dhe konkurrencën pozitive, ndërsa pranoi se skuadra po punon për ta marrë maksimumin nga dy ndeshjet e para.

Rikthehet grupi i 2016-s. Si po përgatitet Shqipëria dhe cilat janë synimet për këto eliminatore?
Basha: Për t'i rikthyer të gjithë është problem, pasi disa kanë lënë futbollin dhe disa kanë moshë të madhe, por kemi disa ndryshime interesante. Atmosfera është mjaft e mirë dhe po përgatitemi seriozisht, duke i dhënë seriozitetin maksimal ndeshjes së parë. Edhe në Euro 2016 shkuam pasi morëm një fitore në ndeshjen e parë në Portugali. Është e vështirë, pasi kemi një kundërshtar shumë të fortë, por do të luajmë për tri pikë.

Pas një viti të vështirë në 2018-n, pse duhet të jemi optimistë për eliminatoret?
Basha: Ka qenë e vështirë veçanërisht në ndeshjet miqësore, pasi trajneri ka vendosur të thërrasë shumë emra të rinj, për t'i testuar lojtarët që mund t'i shërbejnë skuadrës. Në Ligën e Kombeve kemi fituar me fitore ndaj Izraelit, ndërsa kur luajtëm ndaj tyre në transfertë, humbëm në mënyrë tërësisht të pameritueshëm. Kemi peng ndeshjen në transfertë ndaj Skocisë, por këtu shkoi keq, pasi mbetëm me 10 futbollistë.

A ka Shqipëria mundësitë ta përsëritur suksesin e Euro 2016-s?
Basha: Shanset janë për të gjithë skuadrat, pasi futbolli ka ndryshuar dhe nuk ka shumë diferencë mes ekipeve. Nuk duhet të nënvlerësojmë as ndeshjen ndaj Andorrës, pasi nuk mund të fitojmë me lehtësi. Na duhet edhe pak fat, por duhet të bëjmë më mirë, sepse më keq nuk mund të bëjmë me rezultatet.

Trajneri Panucci ka paralajmëruar disa ndryshime. A ka folur me ju në lidhje me këtë çështje?
Basha: Seanca e parë dhe trajneri u mundua më shumë ta shikojë formën e lojtarëve, ndaj sot besoj se do të futemi në detaje, për të mësuar se me çfarë strategjie do të përballemi me kundërshtarin.

Pas problemeve në ditët e fundit, si është atmosfera në grup?
Basha: Vendimi i Lenjanit është personal, ndërsa për Thomasin ka vendosur trajneri, duke konsideruar një thyerje disiplinore. Gjithsesi kjo nuk duhet të ndikojë në sjelljen tonë në stërvitje dhe në fushë.

Konkurrenca në mesfushë është e madhe, pasi janë rikthyer shumë futbollistë…
Basha: Konkurrenca është gjithmonë e mirë dhe pozitive për çdo skuadër. Abrashi luan në Bundesligë, ndërsa Kaçe prej vitesh në Greqi, pastaj jemi edhe ne pleqtë, unë e Memushaj, por konkurrenca është pozitive.

A e vë në dyshim fanellën e titullarit konkurrenca, apo pranoni edhe stolin?
Basha: Unë dhe Memushaj kemi disa vjet këtu dhe gjithmonë jemi sjellë në mënyrë korrekte, duke pranuar çdo vendim të trajnerit. Ne nuk presim të na sjellë kombëtarja klube si Reali apo Barça, por jemi vënë në dispozicion që ta çojmë sa më lart emrin e saj.

Si duhet t'i ndihmoni lojtarët e rinj që të integrohen në grup?
Basha: Duhet t'i ndihmojmë, duke u sjellë shumë me pozitivitet që në grumbullimin e parë, por edhe në vijim, në stërvitje e ndeshje. Synimi është t'ua mësojmë disiplinën dhe motivimin tonë kur luajmë për këto ngjyra, pro edhe t'i inkurajojmë kur gabojnë.

San Antonio triumfon ndaj kampionëve të Golden States

SAN ANTONIO, 19 MARS - San Antonio ka mundur 111-105 Golden State, ndeshje e dominuar nga skuadra e Spursit. Fitorja e 42-të sezonale për San Antonion, që hedh një hap të madh drejt konsolidimit në një vend në "play-off" në Perëndim. DeRozan me 26 pikë e Aldridge me 23 ishin dy lojtarët më të mirë të Spursit, duke fituar duelin me Curryn (25 pikë) e Durantin (24 pikë). Pavarësisht prej humbjes, Golden State e Denveri kanë siguruar kualifikimin për në "play-off" në këtë Konferencë. Jashtë fushës fiton skuadra e Denverit, që mundi 114-105 Bostonin, një përballje mes dy ekipesh pretendente në konferencat përkatëse. Herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri, por në fund triumfuan miqtë, me Jokiqin që realizoi 21 pikë e 13 rebounde. Miami surprizon Oklahomën, duke fituar 116-107 jashtë fushës, ndeshje ku skuadra nga Florida diktoi në fushë. U dalluan Dragiqi me 26 pikë e Wade me 25, dy lojtarë që e nisën ndeshjen nga stoli. Për Thunderin shkëlqeu George me 31 pikë, por që mbetën për statistikë. Skuadra e Chicagos, falë 24 pikëve të Lopezit, mundi Phoenixin, fitore që mbeti për statistikë, raporton "Telesport".

Ekipi i New Orleansit mundi 129-125 Dallasin pas kohës shtesë, me të zakonshmin Randle që realizoi 30 pikë, duke qenë lider në fushë për miqtë. Fiton edhe Portlandi, që triumfoi 106-98 ndaj Indianas, sfidë me dy pamje, më e mirë për miqtë në të parën (Turneri 28 pikë). Ndërsa në të dytën rikuperuan vendësit me Lillardin që realizoi 30 pikë e 15 asistime.

REZULTATET

Cleveland - Detroit	126-119
Washington - Utah Jazz	95-116
Boston - Denver	105-114
Toronto - New York	128-92
Oklahoma - Miami	107-116
San Antonio - Golden State	111-105
Dallas - New Orleans	125-129
Phoenix - Chicago	101-116
Portland - Indiana	106-98

SHKURT

Kukësi shkarkon Cungun

Armando Cungu nuk do të jetë më trajner i Kukësit. Në një postim në faqen e klubit njoftohet ndërprerja e bashkëpunimit me shkodranin për shkak të rezultateve të dobëta. Për presidentin Safet Gjici "kupa u mbush" me humbjen në Korçë, që ndoshta ka nxjerrë përfundimisht jashtë garës për titull ekipin verilindor (Partizani kryeson me 9 pikë më shumë). Drejtimin e ekipit e ka marrë përsipër Ramadan Ndreu, që mban edhe detyrën e drejtorit sportiv. "Klubi i Futbollit Kukësi njofton përfundimin e bashkëpunimit me trajnerin Armando Cungu. Si pasojë e rezultateve negative të javëve të fundit, drejtuesit e Klubit dhe Armando Cungu kanë arritur me mirëkuptim përfundimin e bashkëpunimit. Falënderojmë trajnerin Cungu për kontributin e dhënë në drejtimin e skuadrës sonë dhe i urojmë suksese në karrierë! Në krye të bankinës sonë do të jetë Ramazan Ndreu, i cili mbante detyrën e drejtorit të menaxhimit te klubi ynë", thuhet në njoftimin e Kukësit.

Bayerni, 150 milionë për Balen

Bayern Munchen është gati të bëjë një çmenduri për Gareth Bale. "The Sun" raporton se uellsiani mund të transferohet në Bundesliga në fundin e këtij sezoni dhe "bavarezët" janë gati të paguajnë 150 milionë euro për t'i siguruar shërbimet e tij. Gjithashtu, kampionët në fuqi të Gjermanisë do ta paguanin yllin e "Los Blancos" 650 mijë euro në javë. Shifra të çmendura që mund ta bindin 29-vjeçarin të largohet nga një ambient ku nuk është ndier asnjëherë mirë, pavarësisht prej trofeve të shumtë të fituar.

Interi e kërkon Dzekon në vend të Icardit

Mauro Icardi parashikohet se do të largohet gjatë verës nga Interi, kurse drejtuesit e klubit italian kanë filluar të mendojnë për zëvendësuesin e tij. "Gazzetta dello Sport" raporton se Edin Dzeko është futbollisti që po shihet si zëvendësues i argjentinasit. 33-vjeçari që është pjesë e Romës ka shënuar 85 gola në 169 paraqitje në Serinë A. Në të kaluarën ka luajtur edhe për Manchester Cityn, Wolfsburgun dhe Teplicen dhe Zeljezniçarin.

Carragheri, Liverpoolit: Mos lejo largimin e Manes dhe Salahut

Jamie Carragher thotë se Liverpooli do t'i shmangë interesimet e klubeve të tjera për dyshen Mohamed Salah dhe Sadio Mane, dhe se Jurgen Kloppi është trajneri i përsosur për këtë skuadër ambicioze. Në të kaluarën, "Reds" nuk kanë mundur t'i ndalë largimet e disa prej yjeve kryesorë, ndërsa më i fundit ishte largimi i Philippe Coutinhos drejt Barcelonës. Ndërkohë që Real Madridi është duke e monitoruar Manen, si dhe e ka alternativë të dytë Salahun. "Mbajtja e lojtarëve është një e arritur e madhe për njerëzit në krye të klubit dhe Jurgen Kloppin. Liverpooli e humbi Philippe Coutinhon jo shumë kohë më parë, por mendoj se tash është më vështirë që t'i rrëmbejnë lojtarët nga ky klub. Natyrisht, nëse lojtarët kërkohen nga Real Madridi dhe Barcelona, është vështirë, sepse shumica e futbollistëve duan të luajnë për këto dy klube", ka thënë Carragher. "Mirëpo, aktualisht, mendoj se lojtarët e admirojnë Jurgen Kloppin dhe duan të jenë pjesë e kësaj aventure", ka deklaruar ish-mbrojtësi i Liverpoolit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 225/19, datë 14.03.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 13 pika 1 e Statutit të QKUK-së, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës të datës 13.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M
Për Anulim të Konkursit publik,

I. **Anulohet në tërësi** Konkursi publik nr. 181, datë 05.02.2019 për **Zyrtar i Lart i Mirëmbajtjes së Pajisjeve Mjekësore**, një pozitë në QKUK;

II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;

III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Përzgjedhës i caktuar sipas Vendimit nr. 181/2 datë 07.02.2019, me Rekomandimin nr. 181/4 datë 13.03.2019, njofton që ky konkurs të anulohet në tërësi për arsye se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm edhe pas vazhdimit të dytë ka qenë një kandidatë dhe në bazë të nenin 6 pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Proceudrave të Konkursit në Sektorin Publik, komisioni kërkon anulimin e tij, të modifikohet më mirë dhe i njejti të publikohet sa më parë që të jetë i mundur.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe kërkesës në fjalë, lejon anulimin e Konkursit publik dhe kërkon që i njëjti të publikohet konform ligjit në fuqi.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

N J O F T I M

ANULOHET konkursi për njërën pozitë Auditor i brendshëm (ZKM-NJAB-003) në Njësinë për Auditim të Brendshëm në Zyrën e Kryeministrit i shpallur me 18 janar 2019 i vazhduar edhe per 7 ditë kalendarike deri me datë 11 shkurt 2019.

Nga pjesëmarrësit në konkurs kërkojmë mirëkuptim.

O B A V E Š T E NJ E

PONIŠTAVA SE konkurs za jednu poziciju Internog revizora (KP-JIR-003) u Jedinici za internu reviziju u Kancelariji premijera, koji je raspisan 18. januara 2019. godine, produžen za još 7 kalendarskih dana, do 11. februara 2019. godine.

Od učesnika na konkursu tražimo razumevanje.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 225/19, data 14.03.2013.

U skladu sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 13 tačka 1 Statuta UKCK, članom 6 tačka 5.1, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Postupaka Konkursa u javnom sektoru, i Preporuka predsednik Komisije za izbor na dan 13.03.2019. godine, Generalni Direktor UBKSK-a izdao je sledeće:

O D L U K A
Za poništenje (anulira) javnog konkursa

I. Ukinut u punom javnom konkursu br. 181, od 05.02.2019.godine za **Viši Službenik za Održavanje Medicinskih Oprema jedna pozicija u UKCK)**;

II. Sektor kadrova je obavezan da primeni ovu Odluku;

III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

